



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org-Jedësicia Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	21-2661
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-04-
Data: Datum: Date:	21.04.2021
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 229/IV/2021
Datë:20.04.2021

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në nenin 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (GZ Nr. 3/2020, 25 gusht 2020), nenin 9 paragrafi 1.3 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi (GZ Nr. 13/2013, 07 maj 2020), në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës së Shëndetit Publik dhe të pikës 42 dhe 42 të Vendimit Nr.01/07 të datës 18.04.2021 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, nxjerr:

V E N D I M

Për aprovimin e Udhëzuesit të përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në transportin publik

1. Aprovohet Udhëzuesi i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në transportin publik (verzioni 1.0)
2. Udhëzuesi është i obligueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohet.
3. Shtojca e bashkangjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që përmes Qarkores Informative të informoj të gjitha institucionet dhe palët e interesit për aprovimin e këtij udhëzuesi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përgjithshëm të MSh;
- Departamentit ligjor të Msh;
- Divizionit për komunikim me publikun të Msh;
- Arkivit të MS

Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë

Shtojca 1: Udhëzues i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në transportin publik (verzioni 1.0)



*Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health*

**UDHËZUES I PËRKOHSHËM
APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË
VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E
COVID-19 NË TRANSPORTIN PUBLIK**

Prishtinë, Prill 2021

Verzioni 1.0

1. Masat mbrojtëse personale në transportin publik

Transporti publik (tren, autobus, taksi) është një shërbim thelbësor. Në kontekstin e pandemisë COVID-19 ekzistojnë dy lloje rreziqesh në lidhje me transportin publik. Së pari, grumbullimi në transportin publik (tren, autobus, taksi) dhe përdorimi i tyre nga një numër i madh njerëzish, mund të kontribuojnë në transmetimin e drejtpërdrejtë të COVID-19, përmes spërklave dhe transmetimin indirekt përmes sipërfaqeve të kontaminuara dhe si rrjedhojë, personeli i transportit publik është në rrezik nga rritja e infektimit. Qeveritë në të gjithë botën udhëzojnë publikun të mbajë një distancë minimale për të zvogëluar mundësinë e transmetimit të virusit. Këto masa janë padyshim më të rëndësishmet, në mesin e të gjitha masave të paraqitura, për operacionet e transportit publik.

Kur përdorni transportin publik, përpikuni të qëndroni të paktën 6 hapa larg udhëtarëve të tjerë ose operatorëve të transportit - për shembull, kur jeni duke pritur në një stacion autobusi ose duke zgjedhur vendet në një autobus ose tren. Kur përdorni mjete udhëtimi/taksi, shmangni udhëtimet e përbashkëta, kur një taksi merr shumë pasagjerë ndërsa uluni në ulësen e pasme në automjete më të mëdha, në mënyrë që të mund të qëndroni të paktën 6 hapa larg vozitësit.

Bazuar në legjislacionin në fuqi në operim janë këto lloje të transportit të udhëtarëve:

- Transporti ndërurban i udhëtarëve me autobus (që organizohet ndërmejt dy e më shumë komunave dhe është në kompetencë të MI-së).
- Transporti urban dhe urbano-periferik me autobus (që organizohet nga brenda territorit administrativ të komunave gjegjëse).
- Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve me autobus (organizohet me shtetet respektive dhe është në kompetencë të MI-së).
- Transporti hekurudhor i udhëtarëve me tren (që është në kompetencë të MI-së).

2. Masat e informimit (për pasagjerë dhe personel)

- Siguroni mjetet për ofrimin e informatave (përmes zërimit, posterëve dhe fletushkave) për masat mbrojtëse anti covid 19 në stacionet qendrore, lokale si dhe mjetet e transportit publik (tren, autobus, taksi).
- Informoni pasagjerët për shenjat dhe simptomat e COVID-19 dhe këshilloni që ata të mos përdorin transportin publik (tren, autobus, taksi), nëse shfaqin simptoma të COVID-19 (kollë, dhimbje fyti, dobësi e lodhje e përgjithshme dhe dhimbje muskulore).
- Të rikujtohen pasagjerët me *'vini re'* çdo 30 min. për masat mbrojtëse.
- Informoni pasagjerët për mbajtjen e distancës fizike në hapësirat e stacioneve qendrore.
- Informoni dhe obligoni pasagjerët në rast se nuk kanë mundësi të distancës fizike, për përdorimin e masave shtesë të mbrojtjes anti COVID-19 (përdorimi i drejtë i maskave, dezinfektimi dhe higjiena e duarve).
- Informoni pasagjerët për higjienën e duhur të duarve, me dezinfektues me bazë alkooli 60 - 70%, para hyrjes dhe pas përdorimit të transport publik (tren, autobus, taksi).
- Siguroni tretësirat me bazë alkooli 60 - 70 % të disponueshme për pasagjerë.
- Parandaloni mbingarkesën në transportin publik dhe në zonat e pritjes, përmes sigurimit të automjeteve të mjaftueshme.

- Staf i cili punon në trafikun urban, nëse ka simptoma të dyshimta për COVID-19, duhet të lajmërohet te mjeku familjar më i afërt.

3. Masat e distancës fizike (për pasagjerë dhe personel)

- Të respektohet distanca fizike në vendet e pritjes, për çdo lloj transporti publik si dhe vendosja e drejtë e maskës që është e obligueshme.
- Me qëllim të sigurimit të distancës fizike të domosdoshme (2 m) ndërmjet pasagjerëve, transporti publik dhe privat me autobus do të punojë me kapacitet 50% dhe përdorim të rreptë të maskave.
- Taksitë do të operojnë me një pasagjer në ulësen e pasme ose deri tre pasagjerë të së njëjtës familje gjithmonë me maska të vendosura nga të gjithë pasagjerët.
- Respektimi i distancës fizike në brendi të mjetit të transportin publik (tren, autobus, taksi) sipas standardit (2m).
- Personeli në stacionet qendrore të mbajë distancë fizike 2 m, krahas zbatimit të masave të përgjithshme anti COVID -19, ose në mënyrë ideale të qëndrojnë pas paneleve prej xhami, plastike apo shiriti ndarës.
- Staf i në mjetet e transportit publik (ngasësi i mjetit të transportit dhe kondukteri), duhet të mbajë distancën fizike pas paneleve prej xhami, plastike apo shirit ndarës.
- Hyrja e pasagjerëve të bëhet nga dyert e pasme, për të siguruar distancën fizike nga vozitësi, nëse kabina e makinës nuk është e ndarë fizikisht nga udhëtarët.
- Rritja e numrit të automjeteve të trafikut urban dhe ndër-urban gjatë orarit të orëve të pikut.

4. Masat e mirëmbajtjes së hapësirave të transportit publik (për pasagjerë dhe personel)

- Hapësirat e stacioneve qendrore duhet të dezinfektohen së paku çdo natë.
- Pastrimi i tualeteve publike të stacioneve qendrore duhet të kryhet me kujdes, me përdorimin e një dezinfektuesi efektiv kundër viruseve, siç është hipokloriti i natriumit 0,1% ose produkte të tjerë virucidë të licencuar, duke ndjekur udhëzimet për përdorim të ofruara nga prodhuesi.
- Mjetet e transportit publik duhet të dezinfektohen së paku çdo natë.
- Pastrimi i shpeshhtë i sipërfaqeve ku qëndrojnë pasagjerët dhe ku qëndron personeli, nëse nuk ka dezinfektues me bazë alkooli 60-70%, mund të përdoret hipokloriti natriumi 0.1%.
- Në hapësirat e stacioneve qendrore duhet të ketë dezinfektues të qasshëm lehtë dhe të dukshëm si dhe gjatë udhëtimit (dezinfektues ne bazë alkooli 60-70%).
- Lecka që përdoret për pastrim disa herë patjetër duhet të dezinfektohet dhe pastrohet para përdorimit tjetër.
- Personeli i angazhuar në pastrim duhet të ketë pajisje personale mbrojtëse (PPM) kur kryen pastrimin.
- Punonjësve të transportit publik duhet t'i sigurohet ajrosja dhe ventilimi.
- Të sigurohet ajrosja ose ventilimi i mjeteve të transportit publik gjatë operimit të tyre (sygjerohet ajrosje sipas mundësive, menjëherë pas shkarkimit të pasagjerëve).